



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:174635

Datë: 23.12.2024

Numri i dokumentit: 06641758

P.nr.112/23.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni penal, me gjyqtarin e vetëm gjykues Lulzim Paçarizi, si dhe sekretaren juridike Behije Karaçica në çështjen penale kundër të akuzuarit N.G, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-së, të e sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë me numër PP/II.nr.93/23, të datës 14.08.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik me datë 19.12.2024 në prezencën e prokurorit të shtetit Anton Hasanaj, i akuzuarit N.G, në mungesë të dëmtuarit R.G., i cili gjendet jashtë vendit, me datë 20.12.2024 mori dhe shpalli, ndërsa me datë 23.12.2024 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI: N.G, nga babai S. dhe nëna S.e lindur M., i lindur me datë ..., në fshatin Ll. Komuna Malishevë ku edhe jeton, me nr. personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i martuar, i ati e 4 fëmijëve, i gjendjes së dobët ekonomike.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse me datë pandehuri me dashje përdor forcën ndaj këtu të dëmtuarit R.G., në atë mënyrë që ditën kritike deri sa i dëmtuari ishte duke punuar në rrjet tek klienti A.A.për kompaninë I.B.Malishevë, në atë moment afrohet i pandehuri duke i thënë të dëmtuarit se çfarë interesi ke ti që të ma ndalësh internetin mua, për çka i dëmtuari i sqaron se nuk ka kurrfarë interesi që ta ndali internetin, por, jam duke e këqyr një klient të ri dhe pas pak do të rregullohet interneti, e po ashtu do të kesh rrjet edhe ti, për çka i pandehuri revoltohet dhe e kap për setre (jakne) të dëmtuarin dhe e godet me boks-grusht në anën e djathtë të nofullës, dhe pastaj largohet dhe shkon tek lokali - marketi i tij, me çka të dëmtuarit ia ka shkaktuar dhimbje fizike dhe shqetësim emocional.

-Me çka ka kryer veprën penale sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-ës.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 7, 17, 38, 39, 40 para. 1 pika 1.3, 43,44, dhe 69, të KPRK-ës, nenit 184 par.1 të KPRK-së dhe neneve 322 dhe 364 të KPP-ës, të akuzuarit i shqipton:

DËNIMIN ME GJOBË

Ashtu që e gjykon me dënim me gjobë në lartësi prej dyqind (200) euro, të cilën shumë i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në xhirollogarinë e kësaj gjykate në afat prej 30 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, në të kundërtën dënimi i shqiptuar më gjobë do të iu zëvendësohet me dënim burgu, në kohëzgjatje prej 10 ditësh, dukë llogaritur çdo 20 euro në një ditë burgu.

I dëmtuari R.Q.G.nga fsh. M. K. Malishevë për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt juridiko civil.

Obligohet i akuzuari i lartcekur që të paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej njëzet euro (20€), për kompensimin e viktimave të krimit shumë prej njëzet (20) euro, ndërsa shpenzime tjera nuk ka pasur, të gjitha këto në afat prej 15 ditë pasi që ky aktgjykim të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

1. Rrjedha e çështjes

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, me datë , ka ngritur aktakuzën PP/II.nr.93/23 me dt. 14.08.2023, kundër të akuzuarit N.G nga fshati L. Komuna Malishevë, për shkak të veprës penale Sulmi nga neni 184 par. të KPRK-ës, duke i propozuar gjykatës që pas mbajtës dhe përfundimit të shqyrtimit gjyqësor si dhe duke i analizuar edhe provat tjera të nevojshme, të njëjtin ta shpall fajtor dhe ta dënoj sipas ligjit.

Me datë 19.12.2024, pranë kësaj gjykate është mbajtur seanca e shqyrtimit gjyqësor në të cilën ishin prezent prokurori i shtetit Anton Hasanaj, i akuzuari N.G, ndërsa i dëmtuari R.G. nuk ka prezantuar ku sipas shërbimit të postës i njëjti gjendet jashtë vendit, prokurori i shtetit ka lexuar aktakuzën derisa i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar në tërësi dhe se nuk ka nevojë për sqarime shtesë dhe se e pranon fajësinë për kryerjen veprës penale e cila i vihen në barrë, pranim ky i cili nuk është kundërshtuar nga palët prezente, me ç'rast gjykata me aktvendim procedural ka pranuar pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit dhe rrjedhimisht seanca e shqyrtimit gjyqësor ka vazhduar me paraqitjen e fjalëve përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Anton Hasanaj në fjalën përfundimtare ka deklaruar: Nuk e kundërshtojmë pranimin e fajësisë të bërë nga e të akuzuarit, pasi që ky pranim i fajësisë është bërë në mënyrë vullnetarë, pa presion duke i ditur pasojat dhe benifitet e një pranimi të tillë. Po ashtu kërkojmë nga gjykata që i njëjti për veprën penale të sulmit nga neni 184 par. 1 të KPRK-së, të shpallet fajtorë dhe të dënohet sipas ligjit, i propozoj gjykatës që me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit ti merr parasysh rrethanat lehtësuese dhe rrethanat rënduese dhe te obligoj ne pagesën e shpenzimeve procedurale.

I akuzuari N.G në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar: Edhe një herë deklaroj se e pranoj fajësinë, jam penduar, kërkoj falje, ky ka qenë rasti im i parë që kam ra ndesh me ligjin, i premtoj gjykatës që në të ardhmen dot e jem më i kujdesshëm që mos te kryej kurrfarë vepre penale, jam mbajtës i familje prej 7 anëtarësh , dhe me kushte te vështira ekonomike, andaj kërkoj nga gjykata që ti merr parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit dhe te me shqiptoj një dënim sa më të butë.

2. Vlerësimi i pranimi të fajësisë

Gjykata pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë qenë palët e lartcekura, pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të akuzuarit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë në kuptim të nenit 322 lidhur me nenin 242 para. 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i akuzuari e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimi të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit pas konsultimeve të mjaftueshme me mbrojtësin e tij, se i akuzuari nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza përkatësisht ky pranim i fajësisë gjen mbështetje në provat materiale të cilat i janë bashkangjitur aktakuzës si: Raporti i policit A.S.me nr. ..., i datës 16.01.2023, deklaratat e të dëmtuarit R.G., dhënë në polici me datë 16.01.2023, deklarata e të pandehurit N.G, dhënë në polici me datë, si dhe shkresat tjera të lëndës, gjithashtu gjykata me rastin e pranimin të fajësisë ka gjetur se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: se i akuzuari N.G, ka kryer veprën penale Sulmi nga neni 184 par.1 të KPRK-ës në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes dhe shqiptimit të dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprave penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata me rastin e caktimit të dënimit pati parasysh rrethanat lehtësuese si pranimin e fajit nga ana e të pandehurit, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla penale, është i gjendjes së dobët ekonomike, i ati i 4 fëmijëve, mbajtës i familjes prej 7 anëtarësh me punë sezonale, për herë të parë ka ra ndesh me ligjin, ndërsa duke mos gjetur rrethanë rënduese, andaj gjykata të akuzuarit i shqiptoj dënimin me gjobë në shumë prej dyqind (200) euro, gjithnjë duke konsideruar se me dënimin e

shqiptuar ndaj të akuzuarit mund të arrihet qëllimi i dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

5. Vendimi lidhur me realizimin e kërkesës pasurore juridike

Vendimin mbi udhëzimin në kontestin civil është marr konform nenit 462 par. 1 dhe 2 të KPPK-së.

6. Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Vendimin mbi paushallin gjyqësor gjykata e mbështet në nenin 449 par.1 dhe 2 KPPK-së, ndërsa vendimin në emër të kompensimit të viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par.3 nënpar. 3.1 të Ligjit nr.05/L036 për kompensimin e viktimave të krimit.

Me sa u tha më lart u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimit e konform nenit 364 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË-DEGA MALISHEVË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal
P.nr.112/23, me datë 20.12.2024

Sekretarja Juridike
Behije Karaçica

Gjyqtari i vetëm gjykues
Lulzim Paçarizi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes së të njëjtit, nëpërmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit në Prishtinë.